

Kushtet e Pergjithshme te Kontrates se Sigurimit te Aksidenteve Personale

1.- Objekti i kontrates

1.1 Me ane te kesaj kontrate, Siguruesi dhe i Siguruari bien dakort si me poshte:

Kundrejt detyrimit te pagimit te primit te sigurimit ne favor te Siguruesit, ne perputhje me kushtet e sigurimit te kesaj kontrate ose te shtuara ne te, Siguruesi do te demshperbleje te Siguruarin, ne menyren dhe masen e parashikuar ne kete kontrate, nese vertetohet nje nga ngjarjet e sigurimit, si vijon:

1.1.1 Vdekja aksidentale e personit te siguruar.

1.1.2 Paaftesia e perhershme plete e personit te siguruar.

1.1.3 Paaftesia e perhershme pjesshme e personit te siguruar

1.1.4 Paaftesia e perkohshme e plete e personit te siguruar.

Neni 2 Perkufizime

Eshte dekluar shprehimisht dhe eshte rene dakort, midis Siguruesit dhe te Siguruarit, se per qellime te kesaj kontrate:

-Vdekja Aksidentale eshte vdekja si rezultat i nje aksidenti, dhe jo me vone se 12 muaj nga data e ndodhjes se aksidentit. Kjo police nuk mbulon vdekjen per shkak semundjeje. Ne rastin kur vdekja ka lidhje me nje aksident, por qe eshte favorizuar nga probleme mjeksore paraekzistuese, atehere kjo vdekje nuk mbulohet

-Aksident do te konsiderohet ngjarja nga mjete te rastit, te dhunshme, te dukshme, te jashtme, te pavarura nga vullneti i te siguruarit.

2.1 Kushtet e pergjitheshme te kontrates se sigurimit te aksidenteve, polica e sigurimit dhe dokumentacioni qe i bashkelidhet atyre, ketu e me poshte do te quhet "**Kontrata e sigurimit**".

2.2 Kushtet e pergjitheshme te kontrates te sigurimit te aksidenteve ketu e me poshte, do te quhen "**Kushtet e sigurimit**".

2.3 Personi fizik, i cili do tw sigurohet sipas kontrates se sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet "**I Siguruari**".

2.4 Kompania e sigurimi, ketu e me poshte, do te quhet "**Siguruesi**".

2.5 Personi fizik apo juridik, qe nenshkuaran kontraten e sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet "**Kontraktuesi**".

2.6 Dokumenti qe verteton lidhjen e kontrates se sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet "**Polica e sigurimit**".

2.7 Deshmia e sigurimit qe "Siguruesi" i leshon te "Siguruarit", ketu e me poshte, do te quhet "**Certifikate e Sigurimit**".

- 2.8** Personi fizik apo juridik, qe perfiton nga kontrata e sigurimit mbi bazen e vullnetit te shprehur nga i siguruari ne certifikaten e sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet **“Perfituesi”**.
- 2.9** Shuma e mjeteve monetare qe i Siguruari dhe/ose kontraktuesi i paguajne Siguruesit per lidhjen e kesaj kontrate, ketu e me poshte, do te quhet **“Prim i sigurimit”**.
- 2.10** Shuma maksimale, qe Siguruesi merr persiper te paguaje me vertetimin e ngjarjes te sigurimit, ne favor te te Siguruarit apo Perfituesit, ketu e me poshte, do te quhet **“Shuma e sigurimit”**.
- 2.11** Shuma e mjeteve monetare, qe Siguruesi i paguan, te Siguruarit apo Perfituesit, me vertetimin e ngjarjes te sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet **“Perfitim”**.
- 2.12** Punedhenesi i cili paguan plotesisht apo pjeserisht primin ne favor te Siguruarit, ketu e me poshte, do te quhet **“Policembajtesi”**.
- 2.13** Vdekja ose paaftesia e te siguruarit qe shkaktohen nga mjete te rastit, te dhunshme, te dukshme, te jashtme, te pavarura nga vullneti i te siguruarit , ketu e me poshte, do te quhet **“Rasti /Ngjarja i sigurimit”**.
- 2.14** **“Aksident”** do te konsiderohet ngjarja nga mjete te rastit, te dhunshme, te dukshme, te jashtme, te pavarura nga vullneti i te siguruarit.
- 2.15** **“Vdekja Aksidentale”** eshte vdekja si rezultat i nje aksidenti, dhe jo me vone se 12 muaj nga data e ndodhjes se aksidentit. Kjo police nuk mbulon vdekjen per shkak semundjeje. Gjithashtu, ne rastin kur vdekja ka lidhje me nje aksident, por qe eshte favorizuar nga probleme mjeksore preekzistuese, atehere kjo vdekje nuk mbulohet.
- 2.16** Shpallja i zhdukur i te siguruarit, per te cilin nuk ka lajme me shume se dy vjet, e qe shpallet i zhdukur nga gjykata me kerkesen e cdo te interesuari, ketu e me poshte, do te quhet **“Zhdukja e te siguruarit”**.
- 2.17** Humbja e plote e aftesise se te siguruarit per te kryer detyrat ne profesionin e tij ose ne cdo profesion tjeter, shkaktuar nga aksidenti, e vertetuar si e tille nga autoriteti mjeksor kompetent, pas mbarimit te periudhes 52 javore nga fillimi i paaftesise, ketu e me poshte, do te quhet **“Paaftesi e perhershme e plote”**.
- 2.18** Humbja e pjeseshme e aftesise per pune, shkaktuar nga aksidenti,,me pasoje humbjen anatomiche apo demtimin funksional te perhershesh te nje ose disa organeve apo gjymtyreve te te Siguruarit, ketu e me poshte, do te quhet **“Paaftesi e perhershme e pjesshme”**.
- 2.19** Humbja e plote e aftesise se te Siguruarit, shkaktuar nga aksidenti, per te perm bushur perkohesish detyrat ne profesionin e tij, ketu e me poshte, do te quhet **“Paaftesi e perkoheshme e plote”**.
- 2.20** Shpenzimet e kryera per trajtimin spitalor dhe nderhyrjet kirurgjikale, shpenzimet per blerjen e medikamenteve mjeksore te rekomanduara nga mjeku, trajtimin me rreze, shpenzimet e bera per transportimin e te siguruarit per ne spital (kur ky transportim kerkon kushte specifike dhe merret persiper nga sherbimi i shendetit publik), si dhe shpenzimet per kryerjen e konsultave speciale mjekesore te cilat lindin si pasoje aksidentit, ketu e me poshte, do te quhen **“Shpenzime mjekesore”**.
- 2.21** Humbja fizike ose funksionale e nje dore, ne ose mbi artikulacionin e brylit, apo e nje kembe, ne ose mbi artikulacionin e gjurit, ketu e me poshte, do te quhet **“Humbje gjymtyre”**.
- 2.22** Limiti maksimal i shumes monetare, qe Siguruesi merr persiper te paguaje, ne ndodhjen e rastit te sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet **“Pergjegjesi aggregate”**.
- 2.23** Kohezgjatja, per te cilin eshte ne fuqi kontrata e sigurimit, ketu e me poshte, do te quhet **“Periudha e sigurimit”**.

Neni 3

E drejta per te qene i siguruar

Ne grupin e te siguruarve perfshihen personat qe jane deri ne 65 vjec, ata qe nuk kerkojne kujdes te perhershesh mjeshesor dhe qe nuk e mbeshtesin jetesen ne kujdesin e te treteve. Te Siguruarit qe arrijne moshen kufi, kur kontrata e sigurimit eshte ne fuqi, do te mbeten te mbuluar deri ne mbarim te afatit te treguar ne kete kontrate sigurimi.

Neni 4

Perfitime te pagueshme

4.1 Perfitimi per vdekjen aksidentale ose Zhdukjen - paguhet ne masen 100 % te shumes se siguruar.

Ne perfitimin per vdekjen a zhdukjen jane te inkluduara te gjitha perfimet e tjera, te pagueshme nga Siguruesi deri ne momentin e ndodhjes se ngjarjes.

4.2 Perfitimi per paaftesine e perhershme te plote - do te paguhet ne masen 100 % te shumes se sigurimit, duke u konsideruar si e tille:

- humbja totale dhe e pa riparueshme e shikimit ne te dy syte;
- humbja totale nga gjymtimi fizik apo humbja e funksionit te dy ose me shume gjymtyreve se bashku;
- humbja e plote e shikimit ne nje sy dhe humbja e nje gjymtyre, se bashku.

Ne te gjitha perfitimet e mesiperme eshte inkluduar perfitimi per paaftesi te perkoheshme.

4.3 Perfitimi per paaftesine e Perhershme te pjesshme - llogaritet ne perqindje mbi shumen e siguruar sipas, ne baze te perqindjeve dhe kritereve te meposhtme:

Humbja e plote anatomike ose funksionale e:

	e djathje	e majte (%)
gjymtyre e siperme mbi artikulacionin e brrylit	70	60
nje dore apo parakrah	60	50
imobilitet i artikulacionit te kycit	40	30
gishti i madh i dores	18	16
gishti tregues	14	12
gishti i mesem ose i unazes	8	6
gishti i vogel i dores apo i kembes	12	10
nje falange e gishtit te madh te dores	9	8
nje falange e gishtave te tjere te dores	1/3 e gishtit perkates	
hubja e nje syri	40	
nje kembe nen kyc	40	
nje gjymtyre e poshtme mbi gjurin	60	
nje gjymtyre e poshtme ne apo nen gju	50	
imobilitet total i kofshes ne nivelin e artikulacionit	40	
koksofemoral		
imobilitet total e perdorimit te nje kembe ne nivelin e nyjes se kembes	30	
gishti i madh i kembes	5	
gishti tjeter i kembes	3	
nje falange e gishtit te madh te kembes	2,5	
nje falange e gishtit tjeter te kembes	1	

shurdhimi i plote ne nje vesh	10
shurdhimi i plote ne te dy veshet	40
shpretka	10
nje veshke	30
humbje e plote e zerit	30
ngushtim hundor i dyanshem	15
ndrydhje e vertebrave te qafes	10
vertebrat kurriore	7
e 12-ta kurriore	12
5 kryqe	12
frakture e kerbishtit dhe bishtit me deformim dhe	5
dhimbje	

Siguruesi paguan demshperblimin per pasojat e drejtperdrejta dhe ekskluzive te shkaktuara nga aksidenti. Ne rast se ne momentin e ndodhjes se aksidentit i Siguruari nuk eshte fizikisht i plote dhe i shendetshem, jane te demshperblyeshme vetem pasojat qe do te vertetoheshin sikur aksidenti do t'i kishte ndodhur nje personi fizikisht te plote dhe te shendetshem.

Ne rast se shkaktohet humbja anatomike ose pakesimi funksional i nje organi ose gjymtyre te demtuar para aksidentit, perqindjet e treguara me siper do te zbriten duke marre parasysh shkallen e invaliditetit te meparshem.

Kur i Siguruari eshte mengjerash, perqindjet e mesiperme lidhur me gjymtyret e djathta do te vlejne per ato te majta dhe anasjelltas.

Ne rast se per shkak te aksidentit vjen si pasoje pakesimi por jo humbja e plote, perqindjet e treguara me lart do te pakesohen ne perpjasetim me shkallen e humbjes anatomike apo funksionale.

Ne rastet e paaftesise se perhereshme te papercaktuar ne tabelen e mesiperme perfitimi caktohet duke iu referuar perqindjevet te treguara me lart, duke patur parasysh shkallen e humbjes se aftesive normale mendore e fizike te te siguruarit.

Ne rast se i Siguruari peson humbje anatomike apo funksionale te ndryshme (te painkuadrueshme tek njera tjetra) Siguruesi paguan perfitimin te barabarte me shumen e perqindjevet te paaftesise per cdo humbje, por jo me shume se 100 % te shumes se siguruar.

4.4 Perfitimi per paaftesine e perkoheshme e plote - paguhet ne masen 0.10 % te shumes se siguruar, por jo me shume se 1 500 leke ne dite.

Perfitimet per paaftesi te perkohshme do te paguhen per nje periudhe jo me shume se 52 jave, qofte dhe jo te vijueshme, por pa perfshire paaftesine e te Siguruarit ne ditet e pushimit.

4.5 Perfitimi per shpenzime mjekesore - paguhet si perfitim shtese nga siguruesi deri ne masen 5 % te shumes se siguruar.

Neni 5

Te dhenat qe duhet ti dorezohen Siguruesit

Kontraktuesi dhe/ose Policembajtesi duhet ti dorezoje Siguruesit, te dhenat qe percaktojne identitetin e te gjithe pjesemaresve te grupit.

Keto te dhena i dorezohen Siguruesit ne:

5.1 daten e fillimit te polices,

5.2 cdo date te rinvimit te polices,

5.3 castin kur cdo pjesemares i perfshire ne grupin e siguar, behet i sigurueshem per nje shume me te madhe sigurimi.

Neni 6

Menyra e pagimit te primit te sigurimit

6.1 Primi i sigurimit llogaritet per nje vit kalendarik, por mund te paguhet deri ne 4 keste brenda ketij viti kalendarik. Datat e pagimit te kesteve te primit te sigurimit do te percaktohen ne kontraten e sigurimit, sipas zgjedhjes se bere nga Kontraktuesi ose Policembajtesi, ne mareveshje me siguruesin.

6.2 Kestet e primit te sigurimit do te paguhen prane zyrave te Siguruesit ose agjensise qe ka leshuar polisen e sigurimit, ne diten e percaktuar ne polisen e sigurimit, por jo me vone se 15 dite nga lindja e detyrimit.

Neni 7

Perfundimi i mbulimit ne sigurim

Mbulimi ne sigurim perfundon :

7.1 ne menyre te njehshme, kur njera nga palet nuk permbush detyrimet qe rrjedhin nga zbatimi i kesaj kontrate sigurimi;

- kur pergjegjesia bie mbi Siguruesin, i Siguruari ose Policembajtesi kane te drejten per pjesen e primit te sigurimit te paguar.
- kur pergjegjesia bie mbi te siguruarin a policembajtesin, siguruesi ka te drejten te mos u ktheje shumen e primeve te sigurimit te paguara.

7.2 kur Siguruesi konstaton rrethana te tilla, te cilat po te ishin te njohura ne momentin e kerkeses per sigurim, do te perbenin shkak per mosleshimin e polices se sigurimit;

7.3 kur nuk jane paguar kestet e primit te sigurimit;

7.4 kur i Siguruari arrin moshen kufi te marrjes ne sigurim, 65 vjec;

7.5 kur eshte ekzekutuar plotesisht shuma e sigurimit ose ka mbaruar periudha e sigurimit.

Neni 8

Rreziqe te perjashtuara

Per efekte te kesaj kontrate sigurimi nuk do te mbulohet ngjarja e sigurimit shkaktuar ne kushtet e:

8.1 Vdekja apo paaftesia e te siguaruarit nga shkaqe natyrore apo semundje, duke perfshire edhe infarktin e miokardit.

8.2 luftes, pushtimit ushtarake, akteteve armiqesore te jashtme, veprimeve ushtarake (pavaresisht nese lufta eshte e shpallur apo jo), luftes civile, rebelimit, revolucionit, revoltave te brendeshme, grushteve te shtetit, kryengritjes se armatosur.

8.3 kontaminimit radioaktiv, shperthimeve berthamore, permbytjeve, zhvendosjes se tokes, termeteve, shperthimeve vullkanike.

8.4 drejtimit te mjeteteve motorrike tokesore, ujore, ajrore, pa qene i paisur me deshmine perkatese te aftesise, apo te qenurit si pasagjer ne mjetet e lartpermenduara te pa licensuara per transport pasagjeresh nese i siguruari ka patur dijeni ose mund dhe duhet ta dinte nje fakt te tille.

8.5 perdonimit te aeroplaneve pa motorr, qendrimit si pasagjer ne to, si dhe parashutimit, perdonimit te lendeve eksplozive dhe korodive, pervec rasteve kur eshte ne permbushje te detyres profesionale;

- 8.6** perfshirjes se te siguruarit ne veprimtari te paligjeshme, apo kriminale.
- 8.7** vetevasjes, nese ndodh ne 12 muajt e pare te rinoimit te mundeshem te polices sigurimit;
- 8.8** akteve te kryera me dashje apo te tentuara nga i Policmbajtesi, kontraktuesi apo perfituesi ne dem te te siguruarit.
- 8.9** pjesemarrjes se te siguruarit ne sulme apo veprime e kunderveprime te dhuneshme te provokuara me te tretet, pervec kur i siguruari vepron ne kushtet e vetembrojtjes a te nevojes ekstreme.
- 8.10** influences se alkolit apo droges, pervec rasteve kur droga merret sipas keshillave te mjekut dhe nen supervizionin e tij dhe qe nuk ka si qellim shemin e vesit te perdonimit te droges apo pasojave te perdonimit te saj.
- 8.11** çdo lloj difekti fizik ose semundje, paraekzistuese apo qe ndodh gjate periudhes se sigurimit, qe ishte ne dijeni apo padjeni te te siguruarit, qe ndodh per shkak apo pa vullnet te te siguruarit, per cfaredo arsy qofte ajo. I vetmi perjashtim nga ky rast eshte kur semundja qe shkakton vdekjen apo paaftesine ka ndodhur si pasoje direkte e aksidentit te jashtem I cili ne vetvete nuk rrjedh nga nje semundje.
- 8.12** Nuk konsiderohet ngjarje sigurimi e mbulueshme asnje lloj semundje apo çrregullim fizik qe sjell vdekje apo paaftesi te te siguruarit.

Neni 9

Deklarimet e pasakta

9.1 Ne rast se I Sigruari, kontraktuesi a policembajtesi me dashje apo nga pakujdesia ka bere deklarime te pasakta ose ka lene ne heshtje fakte apo rrrethana te tilla per te cilat Siguruesi nuk dote lidhte kontraten e sigurimit, ky i fundit ka te drejte :

9.1.1 te kundershtoje vlefshmerine e kontrates se sigurimit brenda tre muajve nga dita qe ka marre dijeni per mossakesine e deklarimeve ose lenien ne heshtje te tyre duke kerkuar ndryshimin e kushteve te saj;

9.1.2 te zgjidhe kontraten e sigurimit ne rast se ka rrrethana te tilla qe po ti dinte Siguruesi nuk do te kishte lidhur kontraten.

9.1.3 te refuzoje ne rast te vertetimit te ngjarjes se sigurimit dhe ne cdo kohe tjeter pagesen e perfitimeve.

Neni 10

Hyrja ne fuqi e kontrates se sigurimit

Kontrata e Sigurimit hyn ne fuqi ne oren 24.00 te dites se percaktuar ne kete kontrate, me kusht qe te jete paguar i primi i sigurimit, apo kesti i pare i tij, ne arken apo llogarine rrjedhese te treguar nga Siguruesi apo agjensia e tij.

Neni 11

Mos pagimi i primeve te sigurimit

10.1 Kur prane Siguruesit, nuk paguhen primet ne vazhdim, sipas afateve te percaktuara ne kontraten e sigurimit, sigurimi pezullohet duke filluar nga ora 24.00 e dites se pesembedhjete pas mbarimit te afatit te pagimit. Siguruesi ka te drejte qe te kerkoje zgjidhjen e kontrates se sigurimit dhe primet e paguara nuk i kthehen te Sigruarit dhe/ose Policembajtesit. Policembajtesi dhe/ose I Sigruari nuk mund te justifikohet ne asnje rast per mospagimin e primit dhe te pretendoje se Siguruesi nuk i ka njoftuar afatet e skadences.

Neni 12

Rezidencia

I siguruari duhet te jete rezident ne Republiken e Shqiperise per gjate periudhes se sigurimit, por jo me pak se 12 muaj nga data e lidhjes se kontrates se sigurimit. Per te huajt e punesuar ne subjekte juridike me seli a veprimitari ne Republiken e Shqiperise mund te behet sigurimi me liste te hapur, por ne cdo rast ndryshimi i listes duhet ti njoftohet Siguruesit te pakten 10 dite me pare me shkrim dhe ky i fundit brenda 10 diteve te jape pelqimin e tij per kete ndryshim.

Neni 13

Perfituesit

12.1 Perfituesi caktohet me shkrim ne kontraten e sigurimit nga i Siguruari, i cili ne cdo moment mund ta revokoje ose ta ndryshoje kete caktim, me shkrim ose me testament. Data e hyrjes ne fuqi e ketij ndryshimi do te jete data qe kerkohet nga i Siguruari. Nese kjo date nuk percaktohet shprehimi i njoftimin me shkrim te tij, ndryshimi do te jete i vlefshem ne daten qe Siguruesi merr njoftimin.

Neni 14

Ngjarja e sigurimit

14.1 Me vertetimin e ngjarjes Sigurimit, i Siguruari apo Perfituesi detyrohen te njoftojne Siguruesin duke specifikuar rr Ethanat e ngjarjes dhe pasojat e tij, si dhe te zbatojne porosite e dhena nga Siguruesi.

14.2 Nje njoftim i tille do te quhet i dhene Siguruesit menjehere nese eshte bere me shkrim brenda 24 oreve nga ndodhja e ngjarjes se Sigurimit dhe ne cdo rast, jo me vone se 48 ore nga casti kur i siguruari eshte ne gjendje mendore a fizike te kryeje njoftimin, nga casti kur familjaret e te siguruarit a perfituesi kane dijeni per vertetimin e ngjarjes se sigurimit.

14.3 Per te gjitha pagesat e perfitimit qe do te beje Siguruesi duhet te dorezohen paraprakisht keto dokumenta:

14.3.1 Certifikata e lindjes se te Siguruarit;

14.3.2 Kërkesa per perfitim se bashku me certifikaten e Sigurimit dhe/ose polisen e sigurimit

14.3.3 Çdo dokument te kerkuar nga Siguruesi i cili verteton detyrimin e tij per te paguar

14.4 Dokumentacioni i plete i dorezohet siguruesit brenda 30 diteve nga data e ngjarjes se sigurimit. Shpenzimet per grumbullimin dhe dergimin e dokumentacionit jane ne ngarkim te te Siguruarit a Perfituesit.

14.5 Siguruesi duhet te paguaje demshperblimin qe rrjedh nga kjo kontrate sigurimi brenda 20 diteve nga dita e marrjes se dokumentave te nevojshme. Cdo pagese behet ne monedhen e treguar ne kontraten e Sigurimit, prane zyrave te sigurimit ose agjensive te tij.

Neni 15

Leshimi i dublikates

Ne rast se polica origjinale e sigurimit prishet, griset ose behet e palexueshme, Policembajtesi ose i Siguruari duhet te pajiset me nje police sigurimi tjeter me shpenzimet e tyre, ne te cilin permbahet shenimi “**Dublike**”.

Neni 16

Taksat dhe tatimet

Taksat dhe tatimet e detyrueshme sipas ligjit jane ne ngarkim te Policembajtesit dhe/ose te Perfituesve.

Neni 17

Mosmareveshjet

Mosmarreveshjet qe mund te lindin, ne rast se nuk zgjidhen ne mirekuptim, do te zgjidhen nga gjykata e vendit ku eshte lidhur kontrata e sigurimit.

Neni 18

Ligji i zbatueshem

Pervec rasteve kur eshte parashikuar shprehimisht ndryshe ne dispozitat e Kontrates se sigurimit do te zbatohen dispozitat e Kodit Civil.

Neni 19

Dispozita te fundit :

19.1 Polica e sigurimit do te konsiderohet e vlefshme, vetem kur ajo te jetë firmosur nga “I siguruari” dhe “SIGURUESI”. Polica duhet te jetë domosdoshmerisht e vulosur nga Siguruesi.

19.2 Ne rastet kur perfittues eshte një Institucion Financiar, perfittimet nga kjo police do te kufizohen ne vdekjen aksidentale, dhe paaftesine e perhereshme te plote si shkak i aksidentit.

Perfitimi do te jetë i barabarte me Shumen e papaguar te detyrimit te siguruesit ndaj institucionit financiar ne momentin e ndodhjes se ngjarjes se sigurimit.